



Konkluzionet

"Seminari mbi komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë dhe më gjerë -2015-Politikat dhe Zotimet " 12 nëntor 2015

Më 12 nëntor 2015, Zyra për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit në bashkëpunim me Komisionin Evropian ka organizuar seminarine tretë mbi komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, të bashkëkryesuar nga Zëvendës Kryeministri Kujtim Shala dhe Marta Garcia Fidalgo, koordinatorë për romët në Drejtorinë e Përgjithshme të Komisionit për Politikën e Fqinjësisë dhe negociatat e zgjerimit. Pjesëmarrja (rreth 60 persona) përfshiu një gamë të gjerë të bashkëbiseduesit nga qeveria e Kosovës (si në nivel qendror dhe lokal), tre deputetë nga Parlamenti që përfaqësojnë secilin nga komunitetet, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Takimi ishte zhvilluar mu në kohën kur, për shkak të skadimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian 2010-2015 dhe Planit të Veprimit për implementimin, qeveria e Kosovës ka filluar angazhimet e reja hartimin e politikave për vitet 2016-2020, dhe të cilat aktivitete janë në zhvillim e sipër. Qeveria po angazhohet të harton politika të dhe është duke e përgatitur dokumentin e ri në mënyrë gjithëpërfshirëse. Është e rëndësishme që të përfshihen objektivat reale dhe konkrete, duke e identifikuar afatin kohor dhe autoritetet përgjegjëse për zbatimin, si dhe ndarjen buxhetit.

Qëllimi është të përmbushen të gjitha rekomandimet nga këto konkluzione, më së largu deri në mbajtjen e seminarit të ardhshëm, respektivisht brenda një periudhë kohore dy-vjeçare nga seminari i mbajtur më 2015. Gjatë kësaj periudhe, përmbushja e rekomandimeve do të vlerësohet në mënyrë të rregullt.

Seminari është ndarë në dy pjesë kryesore. Së pari, gjendja e zbatimit të strategjisë aktuale dhe planit të veprimit si dhe konkluzionet e seminarit të vitit 2013 që u prezantuan dhe u diskutuan. Së dyti, gjatë pasdites, angazhimet dhe sfidat e ardhshme u diskutuan në mesin e pjesëmarrësve të pesë grupeve punuese që mbulojnë arsimin, punësimin, shëndetësinë, banimin dhe regjistrimin civil. Diskutimet e grupeve punuese identifikuan sfidat kryesore të mëposhtme në secilën prej pesë fushave:

1. **Arsimi:** sfidat në qasjen e arsimit fillor, të mesëm, profesional dhe arsimit të lartë, mungesa e vetëdijes së prindërve që i përkasin komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për rëndësinë e

arsimit, mungesa e transportit për në shkollë, veçanërisht në zonat rurale, segregacionit në shkolla.

2. **Punësimi:** mungesa e kualifikimeve të duhura (lidhur me arsimin), diskriminimin, mungesën e informacionit mbi mundësitë e punësimit dhe procedurat e nevojshme administrative, duke përfshirë edhe nevojën regjistrim në zyrat lokale të punësimit.
3. **Shëndetësia:** diskriminimi nga profesionistët mjekësor, vaksinimi i pamjaftueshme, martesat e hershme, arsimiti i kufizuar mbi shëndetin riprodhues..
4. **Strehimi:** vendbanimet joformale mbeten një sfidë e madhe që duhet të trajtohen nëpërmjet zbatimit të politikave ekzistuese të strehimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Ekziston nevoja për të përfunduar regjistrimin e pronës dhe për të zgjidhur kontestet pronësore.
5. **Regjistrimi civil:** kriteret komplekse ligjore për regjistrimin, mungesa e koordinimit në mes të nivelit qendror dhe lokal dhe në mes të ministrive, kapaciteteve të pamjaftueshme në nivel lokal.

Diskutimet dhe shkëmbimet e pikëpamjeve të rezultuara në rekomandimet e përgjithshme të mëposhtme (shih shtojcën mëposhtme I):

- Përgatitja e draftit të parë të angazhimeve të reja politike si vazhdim i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian (2009-2015). Këto angazhime duhet të jenë realiste, të besueshme dhe të matshme me tregues dhe afate kohore të qarta. Buxheti i mjaftueshëm duhet të ndahet të shpenzohet në çdo angazhim.

Koha: deri në prill 2016. Autoritet përgjegjëse: Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) / Zyra e Kryeministrit (ZKM) / Kryetar i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional.

- Hartimi dhe zbatimi i një plani mbi mënyrën e koordinimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional dhe mekanizmat me ministrinë e linjës, brenda institucioneve përkatëse, në mes të nivelit qendror dhe lokal dhe me organet e tjera relevante qeveritare.

Koha: konsolidimi i vazhdueshëm përgjatë 2016-2018.

Autoritet përgjegjës / organet: ZQM / ZKM / Kryetar i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional.

- Sigurimi i informacionit mbi mënyrën e mbledhjes dhe menaxhimit të të dhënave të ndara sipas përkatësisë etnike është përmirësuar në përputhje me standardet dhe kërkesat e BE-së.

Koha: deri në fund të vitit 2016.

Autoritet përgjegjëse / organet: ZQM / ZKM / Kryetar i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional.

- Sigurimi i informacionit mbi mënyrën se si qeveria është e angazhuar më thellë me shoqërinë përkatëse civile dhe me përfaqësuesit romë, ashkali dhe egjiptianë dhe se si qeveria i përfshinë në proceset e politikë-bërjes me kohë.

Koha: deri në fund të vitit 2016.

Autoritet përgjegjës / organet: ZQM / ZKM / Kryetar i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional.

- Sigurimi informacionit mbi atë se përfaqësuesit dhe shoqëria civile e komuniteteve rom, ashkali, dhe egjiptian janë të përfaqësuar dhe do të përfaqësohen në të ardhmen në ngjarje të ndryshme (duke përfshirë por jo kufizuar ngjarjet e komuniteteve romë, ashkali, dhe egjiptan) në nivel qendror dhe lokal, Aspekti gjinor duhet të merret parasysh.

Koha: nga mesi i vitit 2017.

Autoritet përgjegjëse / organet: ZQM / ZKM / Kryetar i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional në bashkëpunim të ngushtë me komunat.

- Promovimi i shkëmbimit të përvojave më të mira në zbatimin e strategjive dhe planeve të veprimit, si dhe përkushtimet e ardhshme ndërmjet komunave për politikën.

Koha: nga mesi i vitit 2016.

Autoritet përgjegjëse / organet: ZQM / ZKM / Kryetar i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional, në bashkëpunim të ngushtë me komunat.

- Në nivel lokal, zhvillimi i mekanizmave dhe mjeteve për të mundësuar zbatim të përmirësuar dhe monitorimin e angazhimeve të politikave të ardhshme. Mekanizmat dhe mjetet e tilla duhet ti përfshijnë të gjithë partnerët e nevojshëm, përfshirë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, dhe duhet të sigurohet alokimi i duhur i buxhetit për zhvillimin e mekanizmave të tillë.

Koha: nga mesi i vitit 2017.

Autoriteti Përgjegjës / organi: Komunat në bashkëpunim të ngushtë me ZQM / ZKM / Kryetar i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional.

- Sigurimi i informacionit se organet qeveritare përkatëse dhe organizatat e shoqërisë civile janë takuar në mënyrë të rregullt dhe të shpeshtë për ti adresuar çështjet në përpjekje ekipore dhe për të zgjidhur problemet së bashku.

Koha: nga mesi i vitit 2016.

Autoritet përgjegjës / organi: ZQM / ZKM / Kryetar i Komitetit Drejtues Ndërinstitucional.

- Organizatat e shoqërisë civile duhet të luajë një rol më aktiv në nxitjen e politikave integruese në nivel qendror dhe në nivel lokal.

Koha: deri në fund të vitit 2016.

Autoriteti Përgjegjëse / Organizatat e shoqërisë civile.

Diskutimet dhe shkëmbimet e pikëpamjeve të rezultuar në rekomandimet tematike të mëposhtme (shih shtojcën mëposhtme I):

1. Regjistri civil

- a. Kriteret ligjore për regjistrim të bëhen më fleksibël.
- b. Ofrimi i informacionit mbi mënyrën se si regjistrimi civil i fëmijëve të riatdhesuar është duke u përpunuar në mënyrë sistematike.
- c. Regjistrimi rutinorë dhe sistemet e kontrolluara duhet të vendosen në të gjitha komunat me mbështetjen dhe ngritjen e mëtejshme e kapaciteteve të Zyrrave të Gjendjes Civile si dhe Agjencisë qendrore të Regjistrimit Civil.

2. Arsimi

- a.
- b. Përmirësimi i pjesëmarrjes në arsim dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet në arritjen e pjesëmarrjes në arsimin parashkollor dhe reduktimin ose eliminimin e shpenzimeve për të lehtësuar qasjen në arsimin e mesëm.
- c. Ngritja e vetëdijes brenda komunitetit mbi format e diskriminimit dhe parandalimin e tij, duke përfshirë prindërit rom, ashkali dhe egjiptian si dhe studentët.
- d. Ngritja e kapaciteteve të stafit arsimor në identifikimin dhe zgjidhjen e rasteve të identifikuar të të gjitha llojeve të diskriminimit të nxënësve romë, ashkali dhe egjiptian. Rritja e përpjekjeve në luftimin e paragjyqimeve dhe diskriminimit në shkollë, për shembull duke organizuar seminare për mësuesit.
- e. Adresimi i nevojave të transportit në shkollë për nxënësit rom, ashkali dhe egjiptianë, sidomos në zonat rurale.
- f. Bashkëpunimi cilësor dhe efikas në mes institucioneve dhe organizatave relevante në efektivitetin e edukimit ndaj anëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Kur është e nevojshme, përfshirë mbështetjen shkollore si pjesë e sistemit arsimor.
- g. Përfshirja e gjuhës rome në shkollat të ndjekura nga nxënësit romë.
- h. Rritja dhe zhvillimi i ndërgjegjësimit të prindërve për të ndihmuar arsimimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe për të lehtësuar regjistrimin e tyre në shkollë.
- i. Mbajtja e fushatave ndërgjegjësuese me qëllim të uljes së normave të braktisjes në mesin e tri komuniteteve, në veçanti në mesin e vajzave, dhe për të inkurajuar punën e ndërmjetësuesve.
- j. Ofrimi i informacioneve mbi mënyrën se si është përmirësuar zbatimi i kurrikulave për gjuhën dhe kulturën rome.

3. Punësimi

- a. Ofrimi i informacioneve mbi atë se çfarë përpjekjesh duhet ndërmerren për të rekrutuar persona nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin publik, për shembull në shkollat si mësues dhe asistentë të shkollave, duke përfshirë në nivel lokal.
- b. Rritja e numrit të punonjësve të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin publik / privat nëpërmjet politikave trajnuese profesionale dhe të punësimit.
- c. Lansimi i nje fushate informuese për punë dhe nevojën për t'u regjistruar në zyrat lokale të punësimit.
- d. Lehtësimi i punësimit të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në aktivitetet e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural.
- e. Lansimi i iniciativave për të lejuar vetë-punësimin e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.
- f. Përmirësimi i mirëqenies sociale të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

4. Shëndetësia

- a. Përmirësimi i qasjes së pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në kujdesin shëndetësor duke angazhuar ekipe mobile dhe për të siguruar zbatimin e ligjit për sigurimet shëndetësore.
- b. Përmirësimi i shëndetit të nënës dhe fëmijës me vëmendje të veçantë për riprodhim dhe vaksinimin.
- c. Përmirësimi i kushteve sanitare në vendbanimet dhe mjedisin jetësor të romëve, ashkali dhe egjiptian përmes fushatave të ndërgjegjësimit publik të organizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) në zonat e banuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
- d. Vazhdimi i arsimimit të anëtarëve nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian në lidhje me rëndësinë e mbështetjes shëndetësore përmes shfrytëzimit të ndërmjetësve shëndetësore.
- e. Rritja e ndarjes së buxhetit në nivel të Ministrisë së Shëndetësisë për shëndetin dhe zbatimin e mjekësisë së kujdesit shëndetësor parësor / familjar.
- f. Mbajtja e fushatave ndërgjegjësuese për të informuar anëtarët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian lidhur me çështjet mjekësore.

5. Strehimi

- a. Adresimi i problemeve të regjistrimit të pronës, kontestve pronësore dhe legalizimit si dhe vendbanimeve joformale.
- b. Ofrimi i informacioneve mbi rastet ligjore mbi pronën e paluajtshme, për kthimin e personave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, se si është bërë prioritizimi nga gjykatat dhe Agjencitë Kosovare të Pronës.
- c. Lejimi në mënyrë sistematike bëhet ndarja e tokës për familjet e kthyera nga komunitetet rom, ashkali dhe që ata vijnë nga vendet fqinje.
- d. Mbështetje e komunave në zhvillimin dhe zbatimin e skemave të përmirësimit të banimit social për familjet nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
- e. Zbatimi i politikave të strehimit dhe ligjet përkatëse për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.
- f. Zbatimi i projekteve për vendbanimet joformale, banesa sociale për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë për përmirësimin e kushteve të banimit apo ndërtimin e shtëpive të reja.
- g. Identifikimi i nevojave dhe i zhvillimit të një plani të veprimit për përmirësimin e infrastrukturës së vendbanimeve.

Konkluzionet nga Seminari për përfshirjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, me 11 Tetor 2015

No	Konkluzionit /Aktivitetet	Veprimet	Afati kohor	Institucion përgjegjës
I . Çështjet ndër sektoriale				
1	Zhvillimi i Draftit të parë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Përfshirjes së Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare 2016-2020	Validimi i Draftit të parë të Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Përfshirjes së Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare 2016-2020 nga Komiteti Drejtues Ndërinstitucional	Dhjetor 2015	ZQM/ZKM/ Komiteti Drejtues Ndërinstitucional
2	Finalizimi i Draft Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Përfshirjes së Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare 2016-2020	Aprovimi Draft Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Përfshirjes së Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare 2016-2020 Qeveria e Republikës se Kosovës	Prill – Maj 2016	ZQM/ZKM/ Komiteti Drejtues Ndërinstitucional Qeveria e Kosovës

	Publikimi i strategjisë dhe informimi për te gjitha nivelet e institucioneve dhe shoqërinë civile.		Qershor- shtator 2016	ZQM/ZKM/ Komiteti Drejtues Ndërinstitucional. MAPL dhe shoqëria civile
3	Fuqizimi I koordinimit dhe bashkëpunimi ndërinstitucional dhe bashkëpunimi mes mekanizmave ne ministri me institucioneve relevante,mes nivelit qendror dhe lokal	Krijimi i një sekretariatit në ZQM/ZKM Krijimi I task forces në komuna Rishikimi i termave të referencës se Grupit Teknik Punues	Shtator 2016 Shtator 2016 Qershor 2016	ZQM/ZKM, - Qeveria e Kosovës Komunat, MAPL ZQM/ZKM,
4	Bashkëpunimi me shoqërinë civile	Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e Draft Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Përfshirjes së	Q4 2015	ZQM/ZKM, Ministrit e linjës dhe shoqëria civile

		<p>Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare 2016-2020</p> <p>Përfshirja e shoqërisë civile në zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Përfshirjes së Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare 2016-2020</p> <p>Krijimi i data bazës së OJQ-ve që punojnë për të drejtat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në mënyrë që të ketë konsultime gjithëpërfshirës dhe bashkëpunim në mes të qeverisë dhe shoqërisë civile, dhe të zhvillohen takime të rregullta me shoqërinë civile çdo 3 muaj.</p>	<p>Q1,Q2,Q3,Q4 2016</p> <p>Gjate gjithë procesit</p> <p>Shtator-Tetor 2016</p>	<p>ZQM/ZKM, Komunitat, ministritë e linjës dhe shoqëria civile</p> <p>ZQM/ZKM</p>
--	--	---	--	---

5	Shkëmbimi I përvojave për zbatim më të mirë të e Draft Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Përfshirjes së Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare 2016-2020	Organizimi I takimeve me zyrtaret komunal për zbatimin Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Përfshirjes së Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare 2016-2020		ZQM/ZKM, MAPL, komunitat
---	---	---	--	--------------------------

EDUKIMI

Përmirësimi i pjesëmarrësve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian

1	Krijimi i skemës së granteve shkollore për integrim të komuniteteve dhe zhvillimi i programeve të mentorimit / tutorimit për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian	Identifikohen shkollat përfituese të grantit Shkollat hartojnë dhe zbatojnë projektet që dalin nga skema	Gjatë tërë kohës	MASHT
2	Programe plotësuese gjuhësore për fëmijët nga komuniteti rom	Organizohet mësimi fakultativ në gjuhën rome	Gjatë tërë kohës	MASHT
3	Rritja e përfshirjes në arsimin profesional	Organizohen fushata për rëndësinë e arsimit profesional	Prill, maj, qershor, gusht	MASHT
4	Krijimi i kushteve për vazhdimin e arsimimit pas shkollimit	-Organizimi i transportit për nxënës të shkollave të mesme -Organizimi dhe përgatitja e nxënësve për provimet e maturës dhe semi-maturës	Gjatë tërë kohës	MASHT

		-Organizohet skema e bursave për nxënës të shkollave të mesme të larta		
5	Ofrimi i programeve riintegruese për fëmijët e kthyer nga diaspora	Organizohen kurse te gjuhëve lokale për nxënësit e kthyer Organizohet mësimi plotësues për nxënësit e kthyer	Gjatë tërë kohës	MASHT
6	Përfshirja e edukatorëve romë, ashkali dhe egjiptianë dhe asistentëve të tyre në nivelin parafillor dhe	Angazhohen edukatorët nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian Angazhohen asistentë ndihmës/mësues në klasa	Gjatë tërë kohës	MASHT
7	- Motivimi për pjesëmarrje të shtuar në arsim	- Organizohen fushata të vazhdueshme mbi përfitimet e shkollimit - Organizohen vizita dhe takime në familje për	Gjatë tërë kohës	MASHT

		përfitimet e shkollimit		
8	Shkalla e analfabetizmit në rënie	3.5.1 Ofrohen programet për zvogëlimin e shkallës së analfabetizmit	Maj-korrik	MASHT
Parandalimi i diskriminimit në sistemin e arsimit				
9	Legjislacioni primar dhe sekondar i harmonizuar dhe i zbatuar	<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e gjendjes lidhur me diskriminimin në arsim - Zbatimi i ligjit kundër diskriminimit - Zbatimi i Ligjit për Arsimin Parauniversitar respektivisht të standardeve për gjithëpërfshirës 	Gjatë tërë kohës	MASHT
10	- Ngritja e vetëdijes së komuniteti lidhur me format e	-Organizohen fushata të vazhdueshme kundër	Gjatë tërë kohës	MASHT

	diskriminimit dhe parandalimin e tij, përfshirë prindërit dhe nxënësit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian	diskriminimit		
11	Ngritja e kapaciteteve të stafit arsimor lidhur me identifikimin dhe zgjidhjen e rasteve të identifikuar të gjitha llojeve të diskriminimit ndaj nxënësve dhe studentëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian	<ul style="list-style-type: none"> - Zhvillohen module trajnuese për identifikim dhe reagim ndaj diskriminimit - Organizohen trajnime për të identifikuar diskriminimin dhe mënyrat e trajtimit 	Gjatë tërë kohës	MASHT

PUNESIMI

Rritja e numrit të të punësuarve të pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në sektorin publik/ privat përmes politikave të aftësisimit profesional dhe punësimit.

1	Hulumtimi i nevojave mundësisë se përfshirjes se Komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian ne masa aktive te tregut te punës	Gjetjet nga raporteve mbi hulumtimin e nevojave dhe mundësisë së përfshirjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në masa aktive të TP-së		MPMS
2	Përgatitja e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për punësim	Ofrimi i trajnimit të shkathtësive për kërkim të punës		Agjencia për punësim Zyrat për punësim Qendrat për trajnim profesional
Inkurajimi dhe përgatitja e pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për t'i përfshirë ata në aktivitetet e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural				
3	Identifikimi dhe përzgjedhja e	Kryerja e vizitave për t'i	2016	MBPZHR

	individëve nga tri komunitetet të interesuar të përfitojnë nga projektet e financuara nga MBPZHR-ja në fushat vijuese: <ul style="list-style-type: none"> • Pylltari • Bujqësi 	informuar komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian mbi financimin e MBPZHR-së		
4	Trajnimi i pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në bashkërendim me OJQ-të dhe MBPZHR-në mbi Ligjin kundër Diskriminimit dhe Ligjin mbi Barazinë Gjinore	Ofrimi i trajnimit mbi Ligjin kundër Diskriminimit dhe Ligjin mbi Barazinë Gjinore	2016	MBPZHR
SHËNDETËSIA				
Përmirësim i qasjes së pjesëtarëve të të tri komuniteteve në kujdes shëndetësor				
1	Vetëdijesimi I të tri komuniteteve për rendësin e kujdesit shëndetësor	Mbajtja e fushatave për imunizim, sistemit shëndetësor, riciklimin e mbeturinave, mjekimit	2016-2018	MSH

		tradicional, etj.		
2	Ofrimi i kujdesit për shëndetin nënës dhe fëmijës dhe shëndetin riprodhues përmes edukimit, shërbimeve shëndetësore nga perspektiva gjinore	-Ndërmerren aktivitete edukuese dhe informues për kujdesin ndaj fëmijëve dhe grindësi -Vizitat e rregullta e nënave nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që lindin në shtëpi, monitorimi shëndetit e nënës dhe fëmijës	2016-2018	MSH
3	Përmirësimi I imunizimit (vaksinim) të fëmijët të tri komuniteteve	Mbajtja e fushatave senzibilizuese për vaksinim përmes shpërndarjes fletëpalosjeve, poster, programe radio-televizive, etj.	2016-2018	MSH

BANIMI

Përmirësim i cilësisë së jetës dhe ofrimi zgjidhjeve të qëndrueshme për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që banojnë në kushte banimi të papërshtatshme si dhe krijimi i kushteve optimale për mundësimin e kthimit të qëndrueshëm të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Republikën e Kosovës.

1	Identifikimi i nevojave për Banim /në kategorinë që duhet të rinovohen dhe kategorinë e ndërtimeve nga themeli sipas programeve të hartuara për popullsinë në territorin e tyre.	Caktimi I kriterëve	Në periudha kohore prej 3 muajve gjatë vitit.	MMPH
2	Caktimi dhe Vlerësimi I Prioriteteve për familjet ne nevoje për përfshirjen ne programin e banimit	Plani 3 vjeçar I banimit.	3 vjeçar .	MMPH
3	identifikimi i vendbanimeve dhe lagjeve te cilat nuk kane infrastrukture publike:shkollat, shtëpitë e shëndetit,sistemin e kanalizimit,ujësjellësit, rrugët sekondare dhe ndriçimi.	Krijimi I grupit punues për hartimin e programeve komunale infrastrukture (drejtoritë përkatëse, ZKK, komunitetet dhe SHC/OJQ);	Gjate tre viteve ne vijim.	MMPH